



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:223250
Datë: 04.11.2021
Numri i dokumentit: 02361757
C.nr.2675/15

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen juridike kontestuese të paditësit E.V nga Prishtina, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokatura MBN Sh.P.K, me përfaqësues Mexhid Syla, Blerim Syla dhe Nexhat Syla, avokat në Prishtinë, kundër të paditurave Kompania e Sigurimeve “S...” me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Rinor Ramadani, jurist pranë të paditurës, dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit Me seli në Prishtinë, Rruga “Lidhja e Pejës”, pa numër, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Diellza Sinani, juriste pranë paditurës, me objekt kontesti kompensim i dëmit, vlera e kontestit 5,416.00€, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik të datës 18.10.2021, të mbajtur me prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 01.11.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit E.V nga Prishtina.

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 19.06.2015, nga baza e auto përgjegjësisë, për 80% të përgjegjësisë, t’ia paguaj shumat si vijon:

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej 864.00€
- Për friken e pësuar, shumën prej 604.80€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej 80.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 80.00€

- Për shpenzime materiale për shërim, shumën prej 9.60€

III. DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 19.06.2015, nga baza e auto përgjegjësisë, për 20% të përgjegjësisë, t'ia paguaj shumat si vijon:

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej 216.00€
- Për friken e pësuar, shumën prej 151.20€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej 20.00€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej 20.00€
- Për shpenzime materiale për shërim, shumën prej 2.40€

IV. DETYROHEN të paditurat Kompania e Sigurimeve “S...” dhe Byroja Kosovare e Sigurimit, që të dyja me seli në Prishtinë, që paditësit prestimet si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajnë me kamatë ligjore prej 8% në vit, dhe atë për dëmin material nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (10.11.2015), kurse për dëmin jo material nga data e marrjes së këtij aktgjykimi (01.11.2021) e deri në pagesën e tërësishme, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

V. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, mbi shumat e aprovuara si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: për dhimbje trupore - fizike shuma prej 1,920.00€, për friken e pësuar shuma prej 1,244.00€, për rehabilitim fiziatrικό – psikik shumën prej 200.00€ dhe për shpenzime materiale të shërimit shuma prej 4.00€.

VI. DETYROHEN të paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,620.00€ (njëmijë e gjashtëqind e njëzet euro), dhe atë e paditura e parë, Kompania e Sigurimeve “S...”, shumën prej 1,296.00€, për 80% të përgjegjësisë, ndërsa e paditura e dytë Byroja Kosovare e Sigurimit shumën prej 324.00€, për 20% të përgjegjësisë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi E.V nga Prishtina, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, me datë 10.11.2015, në këtë Gjykatë ka ushtruar padi, fillimisht kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, të cilën më pastaj pas marrjes së provës me ekspertizë nga lëmi i komunikacionit e ka zgjeruar edhe kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jo material.

Paditësi, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, në padi, përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se me datë 19.06.2015, në rrugën “A.R” në Prishtinë, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit, me fajin e ngasësit të markës Audi, tipi A4, me numër të targave 04....., i cili fillon veprimin e kthimit majtas pa u bindur se të bëjë këtë kthim pa i rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, dhe si pasojë goditet nga automjeti i markës BMW, tipi 414, me numër të targave DQ-455-AP (Francë). Si pasojë e kësaj goditje, paditësi E.V, kishte pësuar lëndime trupore, për çka ka kërkuar edhe ndihmë mjekësore. Më tej thekson se si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësi ka pësuar dëm material dhe jomaterial, i cili konsiston me dhimbje të përjetuara fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim. Mbi bazën e kësaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke e detyruar të paditurat që paditësit t’ia kompensoj dëmin si në vijim: në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 3,000.00€, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 2,000.00€, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumë prej 100.00€, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 100.00€, në emër të rehabilitimit fizioterapeutik shumë prej 200.00€ në emër të shpenzimeve mjekësore shumë prej 16.00€. Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 12% në vit, e cila për dëmin jomaterial llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit, kurse për dëmin material nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensim 07.07.2015, e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 1,776.00€ dhe atë për padi shumë prej 156.00€, për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 156.00€, për përfaqësimin e paditësit në pesë seanca gjyqësore shumë prej 1,014.00€ (5 seanca nga 202.80 euro), për nxjerrjen e provës me ekspertizë të komunikacionit shumë prej 100.00€, për nxjerrjen e provave me ekspertizë mjekësore shumë prej 300.00€ dhe për taksë gjyqësore për padi shumë prej 50.00€.

E paditura e parë, Kompania e Sigurimeve “S...”, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, pas marrjes së provës me ekspertizë të komunikacionit, nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, duke theksuar se në këtë rast ka përgjegjësi të ndarë në shkaktimin e aksidentit dhe të dëmit mes të të paditurave. E ka kontestuar kërkesëpadinë për nga lartësia, për dëmin material dhe jo material, me pretendimin se shumatat e kërkuara janë tepër të larta dhe nuk përkojnë me dëmin e pësuar nga paditësi, të cilat janë lëndime të lehta trupore, pa zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe nuk ka shëmtim trupor. Andaj i ka propozuar gjykatës që kompensimi i dëmit të bëhet sipas përgjegjësisë së ndarë, për çka e paditura e parë mbetet në ofertën për dëmshpërblim deri në shumën prej 600.00€.

E paditura e dytë, Byroja Kosovare e Sigurimit, në përgjigje në padi, seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë, me pretendimin se kërkesa ndaj të paditurës së dytë është parashkruar konform dispozitës së nenit 357, paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, pasi që zgjerimi i padisë ndaj Byrosë Kosovare të Sigurimit është bërë jashtë afatit ligjor, si atij objektiv dhe atij subjektiv, nga se paditësi ka qenë në dijeni për rrjedhën e aksidentit nga data e aksidentit, bazuar në raportin policor me numër 2015-AR-1406, ku është theksuar se aksidentit i kanë kontribuar të dy automjetet. Mbi bazën e kësaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit, në raport me të paditurën e dytë, ta refuzoj në tërësi si të pabazuar për shkak të parashkrimit.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve, ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Raportin e aksidentit numër 2015-AR-1406, të datës 19.06.2015, të lëshuar nga Policia e Kosovës, Raportin e Qendrës Emergjente me numër të protokollit 21682, të datës 19.06.2015, Raportin mjekësor të datës 24.06.2015, me numër 667, flet dëftesat me numra 69461, 145971, 058967 dhe 149079, të gjitha të datës 24.06.2015, ekspertizën e komunikacionit të datës 31.10.2020 të punuar nga eksperti Sejdi Berisha dhe ekspertizën mjekësore të datës 23.06.2021, të punuar nga ekspertët mjekësor Milazim Haxholli – ortoped dhe Bujar Obërtinca - psikiatër.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datën 19.06.2015, në rrugën “A.R” në Prishtinë, ishte shkaktuar aksident komunikacioni, mes automjeteve me numër të targave 04..... dhe automjetit me numër të targave DQ-445-AP, në të cilin aksident paditësi, i cili ishte pasagjer, kishte pësuar lëndime, fakt ky që provohet edhe me raportin e aksidentit numër 2015-AR-1406, të datës 19.06.2015, të përpiluar nga Policia e Kosovës dhe me ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti Sejdi Berisha, me datë 31.10.2020.

Nga Ekspertiza e Komunikacionit e datës 31.10.2020, e punuar nga eksperti Sejdi Berisha, rezulton se shkaktuar i aksidentit të datës 19.06.2015, është ngasësi i automjetit Audi, me numër të targave 04....., i siguruar tek e paditura e parë, Kompania e Sigurimeve “S...”, si pasojë e shkyçjes, kthimit majtas pa u bindur se nuk i rrezikon ose nuk i pengon pjesëmarrësit tjerë në trafik, ndërsa i siguruari tek e paditura e dytë Byroja Kosovare e Sigurimit (sigurim kufitare), automjeti i markës BMW, me numër të targave G....., nuk ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit, por me shpejtësinë joadekuate ka kontribuar në rritjen e vëllimit të dëmeve.

Gjykata ekspertizën e komunikacionit e ka vlerësuar si profesionale dhe të argumentuar mirë, prandaj të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme pasi që edhe vet palët ndërgjyqësore nuk e kanë kontestuar. Mbi bazën e të lartcekurave gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë sipas kontributit të pjesëmarrësve në aksident dhe ka vendosur që përgjegjësia të jetë 80 % për të paditurën e parë Kompania e Sigurimeve “S...” dhe 20 % për të paditurën e dytë Byroja Kosovare e Sigurimit.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet lartësia e kompensimit si dhe çështja e parashkrimit të kërkesës në raport me të paditurën e dytë, për të cilën përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse kanë paraqitur argumente të ndryshme mes tyre.

Nga Raportet e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës - Qendra Emergjente, me numër 21682 i datës 19.06.2015, Gjykata ka konstatuar faktin se në ditën e aksidentit, paditësi është paraqitur pranë këtij institucioni shëndetësor, i cili ka evidentuar lëndimet e paditësit dhe i njëjti ka pranuar edhe tretman mjekësor.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident trafiku, gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën përmes ekspertizës, me ekspertë nga lëmi i Ortopedisë dhe Psikiatrisë. Ekspertiza është punuar me datë 23.06.2021 nga ekspertët Dr. Milazim Haxholli – Ortopedis dhe Dr. Bujar Obërtinca - Psikiatrisë.

Eksperti ortoped, Milazim Haxholli, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili

gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi E.V, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, që cilësohen si lëndime të lehta trupore. Paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme, si shkak i lëndimeve trupore: ndrydhje gjoksi, ndrydhje të unazave në pjesën e qafës dhe ndrydhje në krahun e majtë. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur. Dhimbje me intensitet të rëndë 1 ditë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 16 ditësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët vazhdojnë të jenë ende prezente, sidomos në sforcime fizike dhe ndryshimeve klimatike. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka theksuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 18 ditë, ndihmë kjo e ofruar për plotësimin e nevojave elementare biologjike, si: veshëmbathja, higjiena personale, ushqimi, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, kontrollat e rregullta specialistike, pasi që këto nevoja nuk ka mundur t'i plotësoj vet si pasojë e paaftësisë së pjesëshme dhe imobilizimit me qafore. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 18 ditë, ushqim i përforcuar me proteina, minerale, vitamina dhe karbohidrate. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në periudhë kohore prej 10 ditë. Eksperti ka gjetur se paditësi nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim trupor.

Eksperti i psikiatrisë, Bujar Obërinca, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi, si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar disa sekonda, në momentin e aksidentit, si reagim i fuqishëm efektiv ndaj rrezikut të çastit (frika nga vdekja momentale). Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 1 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 muaj, kurse frikë sekondare të intensitetit të ulët ka përjetuar në kohëzgjatje për 6 muaj.

Gjykata ekspertizave mjekësore, atë të ortopedisë dhe psikiatrisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, po ashtu e punuar sipas vëllimit të përcaktuar, po ashtu duke ofruar të dhëna lidhur vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Nga fletdëftesat me numra 69461, 145971, 058967 dhe 149079, të gjitha të datës 24.06.2015, lëshuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, gjykata ka konstatuar faktin se paditësi ka pasur shpenzime të shërimit, të provuara me prova materiale, në vlerë prej 12.00€.

Gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore baza juridike e kërkesëpadisë është në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe Ligjit Nr.04/L077 për marrëdhëniet e detyrimeve, e posaçërisht në dispozitat në vijim.

Me nenin 9, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, është përcaktuar mbulesa siguruese, ashtu që sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik. Kurse me nenin 10 të tij përcaktohet e drejta për kompensim për dëmin material dhe jo matrial, i cili duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.

Ligji Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material), ashtu që me nenin 136, paragrafi 1 është përcaktuar se kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkakuar pa fajin e tij. Me nenin 140 përcaktohet se “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkakuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.”. Kurse me nenin 159, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se “në rast aksidenti të shkakuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkakuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”.

Me nenin 137 të të ligjit në fjalë (LMD) përcaktohet se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”. Kurse me dispozitën e nenit 183, paragrafi 1, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.

Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, gjykata gjen se pala e paditur është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të pësuar nga pala paditëse, pasi që shkaktes i dëmit ka qenë i siguruari tek e paditura dhe në këto rrethana, kompensimi i palës së dëmtuar në aksident bëhet mbi bazën e sigurimit nga auto përgjegjësia, konform nenit 136 dhe 159 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve dhe nenit 9, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia.

Prandaj, gjykata duke u bazuar në këto dispozita si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial, posaçërisht duke marr parasysh

natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditësit, vlerësimin në ekspertizave mjekësore, miratoj pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, në vlerën e shpërblimit të dëmit si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi kërkesëpadinë në shumë prej 1,080.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësi sipas mendimit të ekspertit ortoped, si pasojë e aksidentit dhe lëndimeve të pësuar prej tij, ka përjetuar dhimbje të intensitetit të rëndë 1 ditë, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 16 ditësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët vazhdojnë edhe sot.

Në emër të kompensimit lidhur me frikë për paditësin, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 756.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësi, sipas mendimit të ekspertit të psikiatrisë, ka përjetuar frikë primare disa sekondare, frikë primare disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 1 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 3 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët 6 muaj.

Gjykata, vlerëson se shumatat e kompensimit për dëmin jomaterial, të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të dëmshpërblimit, do t'i mundësoj paditësit satisfaksion që të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensoj të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën do ta kishte po që se i njëjti nuk do t'i kishte humbur, si dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të pësuar, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, siç përcaktohet me nenin 183 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve.

Gjykata, në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar, ndihmë e kujdes të huaj, dhe shpenzimet e shërimit, ka aprovuar shumatat si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 179, paragrafi 1 të Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku është përcaktuar se “kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.” Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensim të këtij lloji të dëmit material, për ushqim të përforcuar dhe kujdesin e huaj, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të

dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale. Gjykata, vlerëson se paditësit i takon ky kompensim, duke u bazuar edhe në praktikën e gjerëtanishme gjyqësore, ku është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve, palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi për këtë lloj kompensimi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar, i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Këto kategori të kompensimit, janë të njohura edhe me Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga auto përgjegjësia, e cila nuk është obliguese për gjykatat në rastin e vendosjes, por mund të merret si kriter orientues, rezulton se kompanitë e sigurimeve në rastet e aksidenteve të komunikacionit, të dëmtuarve u njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdesin dhe ndihmën e huaj nga personi i tretë.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar për paditësin, ka caktuar kompensimin në shumën nga 100.00€, brenda kufijve të kërkesës së paditësit, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse sipas mendimit të ekspertit ortoped, si pasojë e aksidentit, paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 18 ditëve, i pajisur me proteina, minerale, vitamina dhe karbohidrate..

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën nga 100.00€, brenda kufijve të kërkesës së paditësit, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse sipas mendimit të ekspertit ortoped, si pasojë e aksidentit, paditësi në kohëzgjatje prej 18 ditëve, ka pasur nevojë për këtë ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë për veshëmbathja, higjiena personale, ushqimi, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, kontrollat e rregullta specialistike.

Në emër të dëmit material për shpenzimet e shërimit, gjykata gjykoi shumë në lartësi prej 12.00€, ngase përmes dëftesave me numra 69461, 145971, 058967 dhe 149079, të gjitha të datës 24.06.2015, lëshuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, është provuar se paditësi ka krijuar shpenzime të shërimit në lartësinë e aprovuar nga gjykata.

Gjykata, ka vendosur si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit që ndërlidhet me dëmin jomaterial, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. Kurse sa i përket dëmit material, gjykata, bazuar në nenin 322 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ka refuzuar kërkesëpadinë për rehabilitim për paditësin, në shumë prej 200.00€ sepse nuk janë ofruar prova mbi bazën e të cilave do të

provoheshin shpenzimet e bëra për qëllime të këtij kompensimi të pretenduar. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të shërimit, e që ndërlidhen me vizitat mjekësore, gjykata ka refuzuar shumën prej 4.00€, pasi që paditësi nuk ka provuar shpenzimet e kryera mbi shumën e aprovuar nga gjykata. Paditësi ka dorëzuar 4 dëftesa, 3 prej të cilave me shuma nga 4.00€ dhe një dëftesë (dëftesa 058967, e datës 24.06.2021) me vlerë 00.00€.

Gjykata i ka vlerësuar si të pa bazuar pretendimet e të paditurës së dytë, Byroja Kosovare e Sigurimit, se kërkesa për dëmshpërblim në raport me të paditurën e dytë është parashkruar. Kjo sepse aksidenti i komunikacionit, nga ku pala paditëse është dëmtuar ka ndodhur me datë me datë 19.06.2015, kurse padinë në gjykatë e ka ushtruar me datë 10.11.2015, që do të thotë se me ushtrimin e padisë në gjykatë është ndërprerë rrjedhja e afatit të parashkrimit të kërkesës. Kjo bazuar edhe në dispozitën e nenit 369 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku është përcaktuar se “parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”. Në rastin konkret, paditësi, pas pranimit të provës me ekspertizë të komunikacionit e ka zgjeruar padinë, të cilën gjykata e ka lejuar me datë 13.01.2021, pasi që e paditura ka dhënë përgjigje në padi, nuk e ka kundërshtuar legjitimitetin real pasiv dhe ka vazhduar të marr pjesë në seancat gjyqësore. Bazuar në dispozitën e nenit 260, të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, pala paditëse mund ta ndryshojë padinë ashtu që në vend të të paditurit të parë ta padisë një person tjetër, që do të thotë se si palë e paditur mund të përfshihet edhe një person tjetër i cili nuk ka qenë pjesë e procesit të zhvilluar deri në fazën përkatëse të procedurës. “Personi i cili hynë në gjykim në vend të palës së paditur duhet ta pranojë atë në gjendjen në të cilën ndodhet në momentin kur hyn në të”, citat nga paragrafi 3 i nenit të njëjtë. Pra me dhënien e pëlqimit të paditurës së dytë për zgjerimin e padisë edhe kundër saj dhe pjesëmarrjen në seancat e shqyrtimit kryesor, e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit, procesin kontestimor e ka pranuar në fazën në të cilën ka qenë, me të gjitha veprimet procedurale të kryera deri në atë fazë të procedurës dhe për këtë edhe padia e ushtruar nga pala paditëse me datë 10.11.2015, ka ndërprerë parashkrimin edhe ndaj të paditurës së dytë, Byrosë Kosovare të Sigurimit.

Duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se të paditësit i takon edhe kamatëvonesa, e përcaktuar me nenin 382 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, sipas të cilit debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi t kryesor, edhe kamatën.

Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8 %) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë. Kamata për dëmin material, në larësi prej 8% në vit, fillon të rrjedh nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë, përkatësisht nga data 10.11.2015, kurse për dëmin jo material nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, përkatësisht data 01.11.2021, e gjerë në përmbushjen e plotë të detyrimit. Kjo pasi që pala paditëse nuk ka provuar se pranë të paditurës/ave ka ushtruar kërkesë për dëmshpërblim, nga e cila kohë do të rridhte për pagesë kamata ligjore për dëmin material.

Gjykata, paditësit nuk i ka njohur kamatën në lartësi prej 12% në vit, pasi që paditësi nuk ka ofruar prova materiale me të cilat do të provonte paraqitjen e kërkesës pranë të paditurës/ave për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 19.06.2015, e në bazë të të cilës do të provohej fakti nëse pala e paditur nuk ka respektuar afatet ligjore nga neni 26, paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia për trajtimin e kërkesën dhe të njoftimin me shkrim të palës së dëmtuar për ofertën dhe refuzimin eventuale të kërkesës. Me dispozitën e nenit 322, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore është përcaktuar se pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër. Andaj në rastin konkret, pala paditëse ka pasur barrën e provës që të provoj faktin e paraqitjes së kërkesës pranë të paditurës/ave për kompensimin e dëmit, e në bazë të cilit do të përllogaritej afati kohor 15 ditor dhe 60 ditor për trajtimin dhe vendosjen në kërkesën e palës së dëmtuar. Mbi bazën e kësaj, gjykata vlerëson se në këtë rast nuk mund të zbatohen dispozitat e nenit 26, paragrafi 6 të Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia për lartësinë e interesit në 12% mbi shumën e aprovuar të kërkesëpadisë, nga se nuk është provuar se pala paditëse ka ushtruar kërkesë pranë të paditurave për dëmshpërblim, e me këtë as vonesa eventuale e palëve të paditur në trajtimin e kërkesës së palës së dëmtuar, andaj duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku në nenin 382, është përcaktuar lartësia e kamatëvonesës prej 8% në vit.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore të neneve 449 dhe 452 të LPK-së, dhe Tarifës së OAK-së, sipas së cilës paditëses i pranohen shpenzimet në shumë të përgjithshme prej 1,620.00€, dhe atë: për përpilim të padisë shumë prej 156.00€, për përfaqësim në seanca tri seanca të mbajtura dhe katër seanca të shtyra pa fajin e avokatit të palës paditëse shumë prej 1,014.00€ (për seanca të mbajtur shumë prej 608.40€ dhe katër seanca të shtyra pa fajin e avokatit shumë prej 405.60€) për marrjen

e provës me ekspertizë të komunikacionit shumën prej 100.00€ dhe për marrjen e provës me ekspertiza mjekësore shumën prej 300.00€ dhe për taksë gjyqësore për padi shumën prej 50.00€. Gjykata ka refuzuar kërkesën e paditësit për njohjen e shpenzimeve për precizimin e kërkesëpadisë shumën prej 156.00€, të bërë me parashtresën e datës 07.07.2021, të dorëzuar në seancën e shqyrtimit kryesor të datë 18.10.2021, nga se në vlerësimin e gjykatës ky shpenzim është konsumuar me rastin e njohjes së shpenzimeve për përpilimin e padisë.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2675/15, datë 01.11.2021

Gjyqtari

Nexhat Qallapeku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.